


SISTEMI ARSIMOR SHQIPTAR

DHE MASAT PËR PARANDALIMIN
E LARGIMIT TË TRURIT



©PARTNERËT SHQIPËRI PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

RRUGA E ELBASANIT, NDËRTESA PARK GATE, KATI 10, APP. 71 / 73, NR POSTAR
2418/1 1010, TIRANË, SHQIPËRI.

WWW.PARTNERSALBANIA.ORG

AUTOR:

ERA SHERIFAJ

GRAFIKA DHE FAQOSJA:

REGANA HYSENBELLI

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje Ekzekutive	2
Arsimi në Shqipëri	3
<i>Pjesëmarrja në arsim</i>	3
<i>Pjesëmarrja në arsimin e mesëm</i>	3
<i>Pjesëmarrja në arsimin e lartë</i>	4
Cilësia e Sistemit Arsimor Publik Shqiptar	5
<i>Zhvillimet dhe sfidat kryesore</i>	6
<i>Shërbimi i këshillimit të karrierës</i>	6
<i>Hendeku gjinor në arsim</i>	6
Reformat Aktuale dhe Zhvillimet e Politikave në Arsim	7
<i>Strategjia e Arsimit 2021- 2026</i>	7
<i>Ligji për “Arsimin dhe Aftësimin Profesional” dhe “Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023-2030”</i>	8
<i>“Strategjia Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023-2030”</i>	9
<i>Udhëzues i orientimit për karrierë (Janar 2023) - Në mbështetje të orientimit për karrierë për nxënësit e klasës së 9-të</i>	10
<i>Përditësimi i Maturës 2021 - Rregullorja dhe Iniciativat e Reja për Maturën 2023</i>	10
<i>Hartimi i “Programit të ri për Zhvillimin Profesional të Mësuesve për Mësuesit në AAP”</i>	10
<i>Hartimi i “Vlerësimeve të Mësuesve dhe Standardeve të Zhvillimit të Mësimin (2021)”</i>	10
<i>Udhëzim i ri për fillimin e vitit shkollor 2021- 2022</i>	10
Rekomandime	11





PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Arsimi luan një rol shumë të rëndësishëm në krijimin e kapitalit njerëzor dhe është një nga faktorët për zhvillimin ekonomik dhe social të një vendi [1]. Në Shqipëri, arsimi ka kaluar nëpër faza të rëndësishme ndryshimi dhe janë ndërmarrë reforma të rëndësishme ndër vite, të cilat kanë përmirësuar aksesin në arsim dhe rezultatet e mësimdhënies[2]. Megjithatë, pavarësisht këtyre zhvillimeve, sistemi arsimor shqiptar përballet me sfida të ndryshme që ndikojnë përmirësimin e tij. Ky dokument politikash prezanton disa masa se si mund të përmirësohet arsimi në Shqipëri përmes një qasjeje inovatore dhe ofron rekomandime se si të parandalohet largimi i trurit (brain drain).

[1] Arsimi në Shqipëri, INSTAT; <http://www.instat.gov.al/en/statisticalliteracy/educationinalbania/#::-:text=Education%20is%20a%20way%20to,age%20where%20enrolled%20in%20education>

[2] Rishikim shumëdimensional i Ballkanit Perëndimor, OECD 2022; https://www.oecd-ilibrary.org/development/multi-dimensional-review-of-the-western-balkans_8824c5db-en

Pjesëmarrja në arsim

Pjesëmarrja dhe regjistrimi i të rinjve në nivele të ndryshme arsimore në Shqipëri është në rënie që prej vitit 2017 deri në 2021[1], dhe numri i studentëve që zgjedhin të largohen nga vendi për të studiuar jashtë është çdo vit edhe më i lartë, i ndjekur nga një tendencë për të qëndruar jashtë vendit pas studimeve (94% e tyre në 2020 [3]), duke nxitur largimin e trurit (brain drain).

Pjesëmarrja në arsimin e mesëm

Nxënësit në arsimin parauniversitar kanë një ulje të vazhdueshme në numër në të gjithë programet, ulje e cila në vitin 2021 arrin 13,2 %, krahasuar me nxënësit në arsimin parauniversitar në 2017-2018. [1] Ulja më e madhe vërehet në arsimin 9 vjeçar/në ciklin e lartë të arsimit (17%) dhe në arsimin e mesëm (14%), krahasuar me vitin 2017-2018[1]. Gjithashtu, shkalla e “braktisjes së arsimit të mesëm” (pasi arsimi i mesëm në Shqipëri nuk është i detyrueshëm) ishte 1.5% në vitin 2021. Kjo përqindje është më e lartë në zonat rurale (3.3%) dhe pjesa më e madhe e nxënësve që braktisin shkollën e mesme janë djem 2% [4].

Varfëria, mentaliteti, qëndrimet prindërore dhe praktikat kulturore, të ardhurat familjare, faktorët dhe rrethanat familjare, niveli arsimor i prindërve, emigracioni i familjes për mundësi më të mira punësimi dhe edukimi më të mirë për fëmijët e tyre, cilësia e arsimit dhe e mësimdhënies në shkolla, infrastruktura në shkolla, distanca dhe logjistika, mungesa e motivimit etj., janë ndër faktorët kryesorë të braktisjes së arsimit të mesëm në Shqipëri dhe uljes së numrit të nxënësve në të gjitha nivelet arsimore.

Në vijim të pasojave të faktorëve të mësipërm dhe performancës së nxënësve, vetëm 27% [5]-29% [6] e nxënësve të regjistruar në arsimin e mesëm të lartë (gjimnaz), diplomohen brenda periudhës 3-vjeçare. Gjithashtu, vetëm 40% [7] e të diplomuarve nga arsimi i mesëm në vitin 2021, janë regjistruar në arsimin e lartë në universitetet shqiptare. Situata nuk duket shumë optimiste edhe për arsimin profesional në vend. Vihet re një rënie prej 11% në regjistrimet në arsimin profesional dhe pjesëmarrja në arsimin profesional vazhdon të mbetet e ulët pasi vetëm 17-18% e të rinjve zgjedhin arsimin profesional në krahasim me arsimin e mesëm.

[3] <https://exit.al/en/exit-explains-the-mass-exodus-of-albanian-students-and-the-impact-on-the-economy/>

[4] Monitorimi i Pjesëmarrjes Politike, Sociale dhe Ekonomike të të rinjve Shqipëri 2021: <https://www.partnersalbania.org/publication/monitoring-of-political-social-and-economic-participation-of-youth-2021-country-report-albania/>

[5] Përqindja e llogaritur vetëm për nxënësit e regjistruar dhe të diplomuar në arsimin e mesëm(gjimnaz) i cili zgjat tre vjet, sipas formulës: numri i nxënësve të diplomuar në vitin 2020 nga në arsimin e mesëm(gjimnaz) / numri i nxënësve të regjistruar në vitin 2017 në arsimin e mesëm(gjimnaz).

[6] Përqindja e llogaritur vetëm për nxënësit e regjistruar dhe të diplomuar në arsimin e mesëm(gjimnaz) i cili zgjat tre vjet. Formula e llogaritjes: numri i nxënësve që kanë mbaruar në vitin 2021 arsimin e mesëm(gjimnaz)/ numri i nxënësve të regjistruar në vitin 2018 në arsimin e mesëm(gjimnaz).

Pjesëmarrja në arsimin e lartë

Në vitin akademik 2021-2022 në Shqipëri, vetëm 21,7% e të rinjve (18-29 vjeç) janë regjistruar në arsimin e lartë [4]. Vërehet një ulje e numrit të studentëve që ndjekin arsimin e lartë, 6% më pak nga viti i kaluar akademik dhe një rënie prej 13% nga viti 2016 në 2021[8]. Rënia e numrit të studentëve të regjistruar në universitetet shqiptare tregon gjithnjë e më shumë se studentë preferojnë të studiojnë jashtë vendit dhe jo në Shqipëri, me synimin për të marrë një arsim më cilësor dhe një diplomë me më shumë vlerë.

Sipas Institutit të Statistikave të UNESCO-s, numri i studentëve shqiptarë që studiojnë jashtë vendit është 11,675 dhe Shqipëria ka një raport lëvizshmërie jashtë vendit prej 9% [9].

Në përgjithësi emigracioni i të rinjve ka një kosto të lartë në vend, ku kostot totale e arsimit të personave që largohen nga Shqipëria në një vit variojnë nga 330 milionë euro në 504 milionë euro, në varësi të strukturës arsimore. Kjo do të thotë një kosto oportune prej 559 milionë euro për sa i përket vlerës së shtuar bruto të humbjes vjetore, që është një efekt negativ i drejtpërdrejtë në PBB të vendit, që do të thotë se çdo person i aftë për punë që largohet nga Shqipëria merr mesatarisht me vete rreth 14,900 euro nga PBB vjetor i ardhshëm [10].

Shkalla e diplomimit nga arsimi i lartë është gjithashtu një çështje shqetësuese, pasi vetëm 23% [11] e të rinjve të regjistruar në arsimin e lartë janë diplomuar brenda periudhës së rregullt kohore(3-vjeçare) akademike të diplomimit.

[7] Formula e llogaritjes: numri i nxënësve të diplomuar në arsimin e mesëm të lartë në qershor 2021 / numri i studentëve 18-vjeçarë të regjistruar në arsimin terciar në shtator 2021.

[8] E llogaritur nga të dhënat e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit

[9] Instituti i Statistikave të UNESCO-s, <http://uis.unesco.org/en/uis-student-flow>; Raporti i lëvizshmërisë jashtë vendit: numri i përgjithshëm i studentëve të nivelit terciar nga Shqipëria që studiojnë jashtë vendit, i shprehur si përqindje e numrit total të studentëve të nivelit terciar të regjistruar në Shqipëri.

[10] Kostoja e emigrimit të të rinjve, WFD, 2018; https://iri.rs/wp-content/uploads/2021/08/Cost-of-youth-emigration-Albania_official-version_compressed.pdf

[11] Formula e llogaritjes: Numri i studentëve (18-29 vjeç) që kanë mbaruar arsimin terciar në 2021 / numri i studentëve (18-29 vjeç) të regjistruar në arsimin terciar në 2018. Një kohëzgjatje mesatare prej 3 vjetësh merret për të gjitha programet.

Cilësia e arsimit publik në Shqipëri ka ardhur duke u përmirësuar gjatë dekadës së fundit. Qeveria shqiptare ka bërë investime të konsiderueshme për përmirësimin e mjediseve/mjeteve arsimore, rritjen e pagave të mësuesve dhe rishikimin e kurrikulave mësimore. Megjithatë, pavarësisht nga këto përpjekje, ka ende disa çështje të rëndësishme që duhen adresuar.

Disa nga shqetësimet kryesore përfshijnë mungesën e burimeve, metodat e vjetruara të mësimdhënies, mungesën e pajisjeve laboratorike, duke përfshirë infrastrukturën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, faktorë të rëndësishëm për mbështetjen e mësimdhënies me cilësi të lartë [12]. Për më tepër, sistemi arsimor dhe i trajnimit vazhdon të vuajnë nga arritje dhe performacë arsimore relativisht të ulët, duke çuar në një fuqi punëtore të pa kualifikuar në mënyrë të përshtatshme, mungesë të aftësive dhe rritje e papunësi të rinjve [13].

Kjo situatë e arsimit në vend ka ulur besimin e qytetarëve në cilësinë e sistemit arsimor shqiptar dhe familjet zgjedhin t'i regjistrojnë fëmijët e tyre në shkolla private, veçanërisht në arsimin e mesëm[9].

Institucionet arsimore private perceptohen si institucione me cilësi më të lartë në Shqipëri krahasuar me arsimin publik dhe nëse do të kishin mundësi financiare, përqindja e shqiptarëve që do të zgjidhnin arsimin privat për fëmijët e tyre mund të ishte edhe më e lartë.

Mungesa e besimit në cilësinë e arsimit dhe mungesa e mundësive për punësim i detyron familjet të zgjedhin emigracionin si një alternativë për të ofruar mundësi më të mira arsimimi dhe punësimi për fëmijët e tyre. Gjithashtu, siç u përmend më lart, shumë studentë zgjedhin të vazhdojnë arsimin e lartë në universitetet e huaja, me synimin për të marrë një arsim më të mirë.

[12] OECD, Rishikime të Vlerësimit në Arsim: Shqipëri; <https://www.oecd-ilibrary.org/sites/7f73878b-en/index.html?itemId=/content/component/7f73878b-en>

[13] Zhvillimet e Arsimit, Trajnimit dhe Punësimit 2021, EFT; https://www.etf.europa.eu/sites/default/files/document/CFI_Albania_2021.pdf

SHËRBIMET E KËSHILLIMIT TË KARRIERËS

06

Vitet e fundit, shërbimet e këshillimit për karrierën janë prezantuar dhe implementuar në shkolla në të gjithë vendin, por efektiviteti i këtyre shërbimeve mbetet i paqartë. Shumica e të rinjve në Shqipëri përballen me vështirësinë për të gjetur një punë dhe shkalla e papunësisë së të rinjve në Shqipëri vazhdon të jetë e lartë në 20.9%.

Në katër vitet e fundit, shumica e studentëve në arsimin e lartë kanë zgjedhur të studiojnë “Ekonomi, Biznes, Financë dhe Drejtësi”, e ndjekur nga “Shëndet dhe Mirëqenie” [1]. Por, për sa i përket nevojave të tregut të punës, 5 profesionet më të kërkuara në Shqipëri janë profesionistët e IT-së, (zhvilluesit e softuerit dhe web-it), profesionistët e kujdesit shëndetësor (infirmieri, radiologji dhe teknologji mjekësore), inxhinierë (ndërtimi, elektrikë, dhe inxhinierë mekanikë), kontabilistë, profesionistë të shitjeve dhe marketingut [14].

Pra, zhvillimi dhe përmirësimi i shërbimeve të këshillimit të karrierës do të kontribuojnë në një orientim më të mirë të të rinjve për arsimimin e tyre në të ardhmen.

HENDEKU GJINOR NË ARSIM

Në vitin akademik 2020-2021, në arsimin e lartë u diplomuan 32,690 studentë, nga të cilët 66,1% e të diplomuarve ishin vajza [1]. Krahasuar me djemtë e rinjë, vajzat e reja janë më të përkushtuara ndaj arsimit dhe kanë një përqindje më të ulët të braktisjes së arsimit të mesëm, një gatishmëri më të lartë për t'u regjistruar në arsimin e lartë dhe një shkallë më të lartë të diplomimit nga arsimi i lartë [4]. Megjithatë, në Shqipëri, vazhdon të ekzistojnë stereotipe gjinore në lidhje me kapacitetet, punët dhe fushat e studimit që vajzat mund të kryejnë dhe ka një potencial të pashfrytëzuar të vajzave të reja në fushën e teknologjisë dhe inxhinierisë, pasi fushat në të cilat shumica e vajzave të reja diplomohen janë “Arsimi” (82,3 %), i ndjekur nga “Arti dhe Shkencat Humane” (79,9 %) dhe “Shkencat Sociale, Gazetaria dhe Informacioni” (79,1%) [1]. Ndërkohë, fushat në të cilat djemtë diplomohen krahasuar me vajzat janë “Inxhinieri, Prodhim dhe Ndërtim” (64,4%), “Shërbime” (63,9 %) dhe “Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit” (61,6%) [1].

[14] <https://praktika.al/top-10-profesionet-me-te-kerkuara-ne-shqiperi/>

REFORMAT AKTUALE DHE ZHVILLIMET E POLITIKAVE NË ARSIM

07

Më poshtë janë renditur disa nga politikat dhe iniciativat aktuale që kontribuojnë në zhvillimin e sistemit arsimor në Shqipëri.

STRATEGJIA KOMBËTARE E ARSIMIT 2021-2026 [15]

“Strategjia e re për Arsimin” për periudhën 2021-2026, është miratuar në fund të vitit 2021 dhe përfshin për herë të parë të gjitha ciklet e arsimit, duke filluar nga arsimi parashkollor e deri te arsimi i lartë. Vizioni i strategjisë është të ofrojë arsim cilësor të bazuar në parime gjithëpërfshirëse dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës. Një politikë e strategjisë lidhet me menaxhimin efikas të sistemit arsimor, rritjen e performancës në nivel shkolle nëpërmjet strukturave profesionale të menaxhimit dhe strukturave të sigurimit të cilësisë.

Përsa i përket edukimit dhe kujdesit në fëmijërinë e hershme (edukimi parashkollor), strategjia parashikon: a) rritjen e përfshirjes së plotë të fëmijëve në arsimin parashkollor dhe b) rritjen e frekuentimit të orëve përgatitore. Në lidhje me arsimin parauniversitar, strategjia parashikon disa ndryshime në terma të zhvillimit të mësuesve, gjithëpërfshirjes dhe pjesëmarrjes në klasat përgatitore dhe zhvillimit të TIK. Ndërkohë, seksioni i arsimit të lartë përfshin objektiva që lidhen me ndërkombëtarizimin e arsimit të lartë; përmirësimin e metodave/strukturave të vlerësimit në lidhje me programet e arsimit të lartë; përmirësimin e infrastrukturës për kërkime shkencore, infrastrukturën e TIK dhe shërbime për institucionet publike të arsimit të lartë [16].

[15] <https://arsimi.gov.al/vendim-nr-621-date-22-10-2021-per-miratimin-e-strategjise-kombetare-per-arsimin-2021-2026-dhe-te-planit-te-veprimit-per-zbatimin-e-saj/>

[16] <https://eurydice.eacea.ec.europa.eu/national-education-systems/albania/ongoing-reforms-and-policy-developments>



LIGJI PËR “ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL NË SHQIPËRI” [17] DHE “STRATEGJIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE 2023-2030 [18]

Shqipëria, që nga viti 2017, ka në fuqi ligjin për “Arsimin dhe Formimin Profesional” dhe tanimë “Strategjinë e re Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive për 2023-2030”. Qëllimi i Ligjit për Arsimin dhe Formimin Profesional është krijimi dhe zhvillimi i një sistemi të unifikuar të AFP-së që mund t’i përgjigjet ndryshimeve socio-ekonomike dhe teknologjike, në përputhje me sistemin e përgjithshëm arsimor, dhe nevojat e tregut lokal dhe global të punës, për të krijuar mekanizma të qëndrueshëm për sigurimin e cilësisë në institucionet e arsimit profesional.

Ndërkohë, “Strategjia e re Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023-2030” fokusohet në punësimin cilësor dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës për të gjithë. Strategjia trajton 16 sfida dhe formulon 16 zgjidhje, të grupuara rreth 5 qëllimeve kryesore: reduktimi i mospërputhjes së aftësive për të gjitha profesionet; rritja e nivelit të aftësive të grave dhe burrave në moshë pune; funksionimin më të mirë të tregut të punës për të gjithë; ndërmjetësimi dhe ofrimi i programeve mbështetëse për punësim efektiv dhe gjithëpërfshirës; dhe sigurimin e punës së denjë për të gjithë, kudo.

[17] <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2017/02/16/15-2017>

[18] <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/561>

"DRAFT STRATEGJIA KOMBËTARE PËR KËRKIMIN SHKENCOR, TEKNOLOGJINË DHE INOVACIONIN 2023-2030" [19]



Aktualisht, draft "Strategjia Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023-2030", dhe plani i zbatimit të saj, kanë qenë në proces konsultimi deri në prill 2023. Një nga prioritetet e strategjisë është rritja graduale e buxhetit për kërkimin shkencor dhe inovacionin deri në vitin 2030 në 1% të PBB-së, duke përfshirë kontributin e të gjithë aktorëve – sektori i biznesit, arsimit i lartë privat, organizatat jofitimprurëse, ministritë dhe bashkitë.

Një prioritet tjetër është rritja e pjesëmarrjes së institucioneve që kryejnë kërkime shkencore në programe në kuadër të BE-së, si Horizon Europe etj. Fokusi kryesor i strategjisë është krijimi i një mjedisi që lehtëson dhe promovon ndërveprimin dhe projektet e përbashkëta ndërmjet institucioneve të kërkimit shkencor dhe komunitetit të biznesit. Ndërkohë, përmirësimi i kapaciteteve të studiuësve shkencorë dhe krijimi i rrjeteve të studiuësve brenda dhe jashtë Shqipërisë, për rritjen e performancës në programet kombëtare dhe ndërkombëtare, është një nga elementët thelbësorë të strategjisë, si dhe zhvillimi i kapaciteteve infrastruktururore të kërkimit shkencor, duke krijuar mjedise të përshtatshme për kërkime shkencore, laboratorë dhe infrastrukturë të kërkimit shkencor.

UDHËZUES I ORIENTIMIT PËR KARRIERËN (JANAR 2023) - NË MBËSHTETJE TË ORIENTIMIT PËR KARRIERËN PËR NXËNËSIT E KLASËS SË 9-TË [20]

Në janar 2023, Ministria e Arsimit dhe Sportit prezantoi Udhëzuesin e ri të Orientimit për Karrierën. Udhëzuesi synon të mbështesë të rinjtë dhe prindërit e tyre, të cilët kanë një ndikim të madh në vendimmarrjen e fëmijëve të tyre. Udhëzuesi gjithashtu do të mbështesë koordinatorin e orientimit për karrierën në shkollë për koordinimin dhe zhvillimin e aktiviteteve të orientimit për karrierën. Ndërkohë, çdo shkollë do të ketë një hapësirë të dedikuar për orientimin për karrierë.

PËRDITËSIMI I RREGULLORES SË MATURËS 2021 – RAPORTI I MATURËS 2022 DHE INICIATIVAT E REJA PËR MATURËN 2023

Rregullorja e Maturës 2021 është përshtatur dhe ka nisur të zbatohet në janar 2021 nga ministria përkatëse [12]. Në vitin 2023 Ministria e Arsimit dhe Sportit, në prezantimin e raportit të Maturës 2022, prezantoi risi të reja për maturën 2023, ndër të cilat është hartimi i testeve speciale për nxënësit me aftësi të kufizuara [21].

HARTIMI I “PROGRAMIT TË RI PËR ZHVILLIMIN PROFESIONAL TË MËSUESVE TË AFP”

Programi i ri u hartua në vitin 2020. Ai u mundëson mësuesve të arsimit të mesëm në shkollat e AFP-së të arrijnë kualifikimet përkatëse dhe të kryejnë trajnimin e detyrueshëm në varësi të diplomës së tyre [12].

HARTIMI I "VLERËSIMEVE TË MËSUESVE DHE STANDARDEVE TË ZHVILLIMIT TË MËSIMIT (2021)"

Standardet e reja për ‘vlerësimin dhe zhvillimin e mësimit’ për mësuesit dhe kurrikulat e reja të bazuara në kompetenca dhe aftësi janë plotësuar nga Agjencia për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin Parauniversitar për këtë nivel [12].

UDHËZIM I RI PËR FILLIMIN E VITIT SHKOLLOR 2021-2022

U miratua udhëzimi i ri për “Vitin shkollor 2021-2022 në arsimin parauniversitar” nga ministria e Arsimit dhe Sportit. Risi në këtë udhëzim është përfshirja e gjuhës angleze si gjuhë e huaj që nga klasa e parë e arsimit bazë dhe ndryshime të tjera që janë reflektim i situatës së pandemisë në vend [12].

[20] <https://www.ascap.edu.al/wp-content/uploads/2023/01/Udhezuesi-i-karrieres-klasa-9-Final-1.pdf>

[21] https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2023/02/Ditari-Mujor-Janar-MAS_compressed.pdf

REKOMANDIME

11

Monitorimi i vazhdueshëm i pjesëmarrjes së të rinjve në arsimin shqiptar është i rëndësishëm. Analizimi i përgjigjeve të pyetjeve si: Pse brezi i ri po largohet nga sistemi arsimor shqiptar? Cila është mosha mesatare? Arsyet pas këtij fenomeni etj. do të japin më shumë të dhëna, të cilat do të kontribuojnë në masat dhe nismat parandaluese për ri integrimin e të rinjve.

Disa nga rekomandimet e ofruara më poshtë do të kontribuonin në përmirësimin e sistemit arsimor në Shqipëri dhe reduktimin e largimit të trurit (brain drain).

01

Replikimi i modeleve të suksesshme arsimore në mbarë botën do të kontribuonte në përmirësimin e Sistemit Arsimor Shqiptar. Shqipëria mund të adoptojë disa nga praktikat më të mira, të tilla si *zvogëlimi i numrit të nxënësve në klasa, krijimi i komuniteteve të vogla dhe ofrimi i vëmendjes së individualizuar për çdo student*. Sigurimi i studentëve me një edukim holistik (të plotë) dhe një sërë mundësish për të zhvilluar aftësitë e të menduarit kritik, e zgjidhjes së problemeve, dhe aftësitë e komunikimit dhe inovacionit që do të kontribuonin në një edukim më tërheqës dhe me ndikim.



02

Rritja e Buxhetit për Arsimin është e nevojshme për të siguruar *infrastrukturën e duhur fizike dhe mësimore*. Është thelbësore edhe **përmirësimi i aksesit në arsim** në aspektin logjistik, veçanërisht për nxënësit me aftësi të kufizuara dhe për ata që jetojnë në distanca të gjata nga shkollat. Kjo do të kontribuojë edhe në përmirësimin e frekuentimit të shkollës.

03

Universitetet duhet të përmirësojnë, përshtatin dhe përditësojnë **kurrikulat dhe metodologjitë e mësimdhënies** në mënyrë që studentët të fitojnë njohuri dhe aftësi të cilat janë koherente me zhvillimet më të fundit. Investimi në **kërkim shkencor** mbetet shumë i rëndësishëm. Gjithashtu, investimi i vazhdueshëm në **ngritjen e kapaciteteve të mësuesve dhe profesorëve** kontribuon gjithashtu për një sistem arsimor më cilësor.

04

Investimi në teknologji në shkolla dhe universitete mund të revolucionarizojë arsimin në Shqipëri. Teknologjia dixhitale ka dëshmuar të jetë një mjet efektiv në të mësuarit dhe në përmirësimin e ndërveprimit midis studentëve dhe mësuesve. Për shembull, *tabelat e bardha interaktive, projektorët inteligjentë, laboratorët kompjuterikë dhe programet edukative software* janë disa nga mjetet që mund të përmirësojnë mësimdhënien në Shqipëri. Me teknologji të tilla ndërvepruese, studentët mund të marrin dhe kujtojnë më shumë informacion dhe të angazhohen më shumë në procesin e të mësuarit. Megjithatë, është thelbësore të përfshihet teknologjia në të gjithë institucionet arsimore në Shqipëri, dhe jo vetëm në disa apo në qytetet kryesore të saj.

05

Korniza Shqiptare e Kualifikimeve duhet të zbatohet plotësisht dhe të përdoret për sigurimin e cilësisë së programeve të arsimit dhe formimit profesional, si dhe atyre të ofruara nga ofruesit e trajnimit privat dhe jofitimprurës.

06

Çertifikimi i Universiteteve Shqiptare të paktën me standardet evropiane do të kontribuonte në vlerën e diplomës, duke qenë ekuivalente dhe e njohur në vendet evropiane.

07

Shërbimet e orientimit për karrierën duhet të zbatohen plotësisht dhe sipas specifikimeve. Gjithashtu, koordinatorët e orientimit për karrierën duhet të jenë ekspertë të kualifikuar, duke ofruar informacion të përditësuar për tendencat e reja të punës, nevojat e tregut dhe të përshtatin shërbimet sipas zonave specifike në Shqipëri, për të mbështetur të rinjtë në marrjen e vendimeve të duhura për të ardhmen e tyre.

08

Mbështetja ekonomike dhe sociale për studentët e familjeve të marginalizuara do të kontribuonte në vazhdimësinë e studimeve dhe përmirësimin akademik të studentëve.

09

Mësimi i bazuar në punë praktike si një strategji arsimore do të kontribuonte në krijimin e eksperiencave praktike të punës për të rinjtë, për të aplikuar aftësitë akademike dhe teknike dhe rritjen e mundësive për punësimin e tyre. Në këtë drejtim, duhet të miratohet rregullorja kombëtare për mësimin e bazuar në punë praktike dhe duhet të zhvillohen mjetet dhe instrumentet e nevojshme mbështetëse. Bashkëpunimi ndërmjet universiteteve dhe bizneseve duhet të forcohet, duke garantuar mundësinë për eksplorimin e punëve të ndryshme, aktivitetet e planifikimit të karrierës dhe të ndihmojë studentët të arrijnë kompetenca të tilla si qëndrimet pozitive të punës dhe aftësi të tjera punësimi.

10

Stimulimi i kthimit të studentëve që studiojnë jashtë vendit dhe parandalimi i largimit të trurit (brain drain). “Programi i Ekselencës” ka pasur sukses në Shqipëri dhe ka tërhequr vëmendjen e shumë shqiptarëve që studiojnë dhe punojnë jashtë vendit. Megjithatë, ky program nuk duhet të fokusohet vetëm në punësimin e të rinjve në sektorin publik, por duhet të inkurajohen kompanitë dhe bizneset private në vend që të marrin pjesë në proces. Ofrimi i mundësive të punës dhe stimulimi i marrëveshjeve kontraktuale për të rinjtë e mirëarsimuar do të kontribuonte në një përqindje më të lartë të të kthyerve, por edhe në uljen e largimit të trurit (brain drain) në Shqipëri. Transferimi i njohurive, aftësive dhe përvojave profesionale nga vendet e tjera në Shqipëri do të kontribuonte në zhvillimin e vendit.



This project is funded
by the European Union

Ky dokument politikash është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij dokumenti politikash është përgjegjësi e vetme e Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.